



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:022171 C. nr. 523/2018
Datë: 14.02.2024
Numri i dokumentit: 06149645

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në kontestin e paditësve S.M. dhe M.M. që të dy nga Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizuarizim i përfaqëson V.O. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson F.H. jurist pran të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit, me vlerë të kontesti 39,400.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor-publike, me datën 01 Shkurt 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M I

I.Miratohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësve S.M. dhe M.M. që të dy nga Komuna e Prizrenit, rruga Sh.B. dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Eurosig” nga Prishtina, që në emër të dëmit material dhe atij jo material, t’ia kompensoj paditësve shumat si në vijim:

Për paditësin e parë S.M.

- për dhimbje fizike duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit shumë prej 1,300.00 €,
- për frikën duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit shumë prej 1,100.00 €,
- për ndihmë dhe kujdes të huaj shumë prej 252.00 €,
- për ushqim të përforcuar shumë prej 90.00 €,
- për shpenzimet e mjekimit shumë prej 25.80 €,

Në shumë të përgjithshme prej 2,767.80 €, duke llogaritur kamatën ligjore prej 8% prej ditës së marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën përfundimtare.

-për dëmin material për veturën e markës “PEUGEOT 307” me numër të regjistrimit 04-810-EC, pronë e paditësit S.M. dhe atë në shumë prej 1,324.25 €, duke llogaritur kamatën ligjore prej 8 % nga dita e aksidentit e derinë pagesën përfundimtare.

Për paditësen e dytë M.M.

- për dhimbje fizike duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit shumë prej 4,000.00 €,
- për frikën duke përfshirë të gjitha llojet e intensitetit shumë prej 2,700.00 €,
- për zvogëlim të aktivitetit jetësorë në shkallë prej 20.80 % shumë prej 10,000.00 €,
- për shëmtim trupor shumë prej 3.000.00 €,
- për ndihmë dhe kujdes të huaj shumë prej 400.00 €,
- për ushqim të përforcuar shumë prej 250.00 €,
- për shpenzimet e mjekimit shumë prej 1,391.50 €.

Respektivisht shumën e tërësishme prej 25,833.55 €, (njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjet e e tre euro e pesëdhjet e pesë cent) me kamatë ligjore prej 8 %, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit deri më pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

II. Obligohet e paditura, që t'ia paguajë paditësve shpenzimet procedurale dhe atë në shumën prej 1,854.00 € (njëmijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër euro), në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësit S.M. dhe M.M. që të dy nga Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tyre av. V.O. pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padinë për kompensimin e dëmit material dhe jo materiale, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Eurosig" me seli në Prishtinë, duke theksuar se paditësit me datën 16.09.2019, rreth orës 07:24 në Prizren, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ashtu që deri te aksidenti kishte ardhur kur vozitësi S.M. e cila drejtonte automjetin e amarkës Renault Trafik ne targa në rrugën Ekrem Rexha, ku arrinë tek marketi Viva Fresh fillon të kthehet me automjetin në të majtë, për të hyrë në firmën Getoari, por pa u siguruar se me këto veprime mund ti rrezikoj pjesëmarrësit e tjerë në trafik, derisa kishte qenë duke u kthyer majtas i pengon veturën Peugeot 307 me targa ngjyr hiri e cila në atë moment kishte qenë duke lëvizur përgjatë rrugës Ekrem Rexha nga drejtimi i Tregut të Shqipërisë, pra në drejtim të HIB Petrol, vozitësi S.M. me që rast shkakton aksidentin e komunikacionit ashtu që me pjesën e përparme me anën e djathtë e godet automjetin Renault në gomën e pame të anës së djathtë. Duke u bazuar në dispozitat e LMD-së, i kanë propozuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin do të aprovohet kërkesëpadia e paditësve S.M. dhe M.M. si e bazuar dhe do të detyrohet e paditura "Eurosig" nga Prishtina, që t'ua kompensoj paditësit dëmin jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditësve av.V.O. nga Prizreni, ka deklaruar se mbetet pranë padisë, kërkesëpadisë si dhe precizimit të bërë më datë 25 Janar 2024, të dhënave pas ekspertizave mjekësore, ashtu që tani ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Eurosing" nga Prishtina, që paditësve t'ia kompensoj dëmin material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 16.09.2019 si në vijim: në emër të dëmit jo material dhe material, t'ia kompensojnë shumën e përgjithshme në lartësi prej 39,400.00 euro me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive. I autorizuari i paditësve i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 1,854.00 euro, më saktësisht të specifikuara sikurse në precizimin e kërkesëpadisë dhe në fjalën përfundimtare.

E paditura më datës 08.10.2021, ka dhënë përgjigje në padin në të cilën ka theksuar se bazuar në dokumentacionin mjekësor të cilën paditësit ia kanë bashkangjitur padisë, rezulton se paditësi S.M. në aksidentin e datës 16.09.2019, ka pësuar lëndime të lehta trupore, bazuar në këtë kualifikim të dëmit duke i ofruar shumën për marrëveshje 450.00 euro, duke konsideruar se kjo shumë është një satisfaksion për palën paditëse konform lëndimeve të pësuar.

Ndërsa bazuar në dokumentacionin mjekësor të cilën e ka prezantuar paditësja M.M. nga e njëjta është kërkuar që pas 6 muajve mbas aksidentit të paraqitet tek mjeku për ekzaminim të drejtëpërdrejtë mirpo e njëjta nuk është paraqitur dhe në këtë mënyrë e paditura nuk ka mundur që ti ofrojë ndonjë shumë të caktuar për paditësen. Sa i përket dëmit për automjetin, paditësi asnjëherë nuk ka paraqitur kërkesë në procedurë të rregullt dhe poashtu nuk ka bashkangjitur

asnjë provë relevante me padi, në këtë rast e paditura e ka të pamundur të deklarohej për dëmin e shkaktuar në automjet derisa të posedojnë prova shtesë. I ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, LMD-së, dhe praktikës gjyqësore të aprovohet pjesërisht kërkesëpadija e paditësve sa i përketë lëndimeve trupore duke i refuzuar shumat e kërkuara mbi shumën e ofruar nga e paditura.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosing”, ka deklaruar se ngelet në tërsi si në deklaratën nga seanca përgaditore, ndërsa në fjalën përfundimtare drejtëpërdrejtë në procesverbal ka theksuar se mbetet në tërësi si në përgjigje në padi deklarimet nga seancat e kaluara si dhe deklarimet në këtë seancë dhe pas administrimit të provave gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovoj pjesërisht si të bazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Ekspertizën e ekspertit Ortoped – Traumatolog Dr. M.H. e datës 06.07.2023, Ekspertizën mjekësore e përpiluar nga eksperti gjyqësor Dr.sci. N.F. psikiatër nga Prizreni, e përpiluar më datë 10.08.2023, Ekspertizën mbi vlerësimin e dëmit në mjetin motorik nga eksperti Ing.dipl. B.L. e përpiluar më datë 31.10.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadija e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Në mes të palëve ndërgjyqëse ishte kontestuese lartësia e kërkesëpadiës e jo baza juridike, të cilën bazë nuk e konteston as pala e paditure.

Në këtë rast, kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadiës, ashtu që për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadiës, gjykata nga ekspertiza mjekësore të punuara nga Dr.M.H. - ortoped e datës 06.07.2023, në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtëpërdrejt të paditësit të parë S.M. ka dhënë mendimin profesional përmes ekspertizës të punuara. Në bazë të ekspertizaës është konstatuar se i dëmtuari S.M. ka pasur ndrydhje në gjoks, ndrydhje në bark. Ndrydhje në bryllin e majtë – Të shkaktuar nga goditja e mjetit të fortë (jo i mprehtë) si pasoj e aksidentit të trafikut dhe si të tillë bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore. Ka pasë dhembje fizike, me intensitet të lartë një ditë, me intensitet të mesëm 18 ditë, me intensitet të ulët ka dhe sot e kësaj dite posaqërisht gjatë sforcimit fizik dhe ndryshimeve klimatike. Nuk ka shëmtim trupor dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Ndihma dhe kujdesi i huaj 18 ditë që nënkuptonë ndihmë mjekësore profesionale dhe ndihmë jo profesionale nga personat e tjerë. Ushqim përforcues 18 ditë, ushqim i pasuruar me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe pasojave të reaksionit post traumatik. Rehabilitim fiziatrik 10 ditë i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjeve në nyjën e qafës, bryllit, dhe belit si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuar si pasoj e shtangimit të zhvilluar në nyje për shkak të pamundësisë së lëvizjeve në kohën e shërimit.

Ndërsa për paditësen e dytë M.M. është konstatuar se e dëmtuara M.M. ka pasur thyerje shumëpjesëshe të kokës së krahut (humerusit) të djathtë. Dëmtimi i nervit medianus, radialis dhe ulnaris të dorës së djathtë që manifestohet me mpirje dhe humbje fuqie në dorën e djathtë të shkaktuar nga goditja e mjetit të fortë, si pasojë e aksidentit në trafik dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të renta trupore. Në momentin e dëmtimit dhe gjatë trajtimit mjekësor, e dëmtuara ka pasur dhimbje fizike me intenzitet posaqërisht të rënd 60 minuta, me intensitet të rëndë 4 ditë, me intensitet të mesëm 50 ditë, me intensitet të ulët vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Shëmtim trupor në shkallë të mesme, për shkak të vragës si pasojë e plagës operatore pas operimit në pjesën e përparme anësore të brryllit në anën e djathtë me gjatësi 20 cm, dhe gjerësi 1 cm, të dukshme kohë pas kohe, si dhe shëmtimit fizik, shtangimit të brryllit dhe vështirësisë në lëvizje. Në rastin në fjalë paditësja ka pasur frikë. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është në shkallë prej 20.80 %, për shkak të kontrakturës të nyjës së brryllit të djathtë si pasojë e lëndimeve të strukturave kockoro-ligamentoze me zvogëlim të lëvizshmërisë së nyjës së brryllit të djathtë në shkallë të mesme (10%) (dora dominante) për shkak të parëzës të nervit radialist djathtas 12.5 %. Ndihej nga personit të tretë 50 ditë që nënkupton ndihmën mjekësore profesionale dhe ndihmë jo profesionale nga personat e tjerë e cila i ka ndihmuar plotësisht të nevojave elementare. Ushqim përforcues 50 ditë të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimeve si dhe reaksionit post traumatik dhe rehabilitim fiziatrik 40 ditë, i cili ka qenë i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjeve të qafës, dhe nyjës së brryllit të dorës së djathtë.

Nga ekspertiza mjeko-ligjore psikiatrike e punuara nga Dr.sci. N.M.F. në bazë të dokumentacionit mjekësor paditësit S.M. dhe M.Gj.M. më datë 16.09.2019, kanë pësuar lëndime trupore dhe frikë në aksidentin e komunikacionit. Paditësi i parë S.M. ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur rreth 2 sekonda në momentin kur e ka perceptuar mundësinë e goditjes së makinës dhe rrezikun fatal të vdekjes, e cila është manifestuar në formë të një bllokimi emocional. Ka përjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, i manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikën që shfaqej sa herë përballëj me gjendjen e tij shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten. Ka përjetuar edhe frikë të intensitetit të mesëm dhe atë dy javë e cila është manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e tij shëndetësore e përcjellur me dhimbje të kohëpaskoshme në trup. Në këtë periudhë i njëjti ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, dhembje e trupit, ndjeshmëri të tepëruar emocionale dhe nervozisëm të shtuar. Është konstatuar edhe frikë sekondare me intensitet të ulët që ka vazhduar rreth një viti e cila frikë është manifestuar me pasiguri të kohë pas koshme prishje të gjumit, nervozizëm si dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin, për këtë është marrë me trajtim psikiatrik. Ka përjetuar edhe frikë të intensitetit të mesëm dhe atë dy javë, e cila është manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e tij shëndetësore, si dhe dhembjet e kohëpaskoshme në trup. Në këtë periudhë i njëjti ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, dhembje e trupit, ndjeshmëri të tepëruar emocionale dhe nervozisëm të shtuar sidomos. Mund të konstatohet se i njëjti ka pasë frikë sekondare me intensitet të ulët që ka vazhduar rreth një viti i manifestuar me frikë, dhe pasiguri të kohë pas koshme, prishje të gjumit, nervozizëm si dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin.

Paditësja e dytë M.Gj.M. ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur rreth 2 sekonda në momentin kur e ka perceptuar rrëshqitjen e makinës dhe rrezikun për vdekje e cila është manifestuar në formë të një britme çjerrëse. Ka përjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikën që shfaqej sa herë përballëj me gjendjen e saj shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten.

Ishte manifestuar me prishje të gjumit, mendimeve negative, shpërthimeve në vaj dhembjeve të trupit plogështi dhe dridhje të trupit. Ka përjetuar edhe frikë të intensitetit të mesëm një muaj e gjysmë e manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e saj shëndetësore, nevojën e mjekimit me hospitalizim, ndërhyrjen operative, ndihmën e personit tjetër si dhe dhimbje të kohëpaskoshme në trup. Po ashtu në këtë periudhë ka ndjerë ankth, frikë, vështirësi për ta zënë gjumi, dhembje të trupit, ndjeshmëri të tepëruar emocionale dhe nervozisëm të shtuar sidomos të lidhura me vështirësitë në funksionimin e përditshëm. Është konstatuar se e njëjta ka pasur frikë sekondare me intensitet të ulët që ka vazhduar rreth një viti i manifestuar me frigë dhe pasiguri të kohë pas koshme, kujtime traumatike, pasiguri, nervozizëm si dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin, për këtë ka marrë edhe trajtim psikiatrik ku i janë përshkruar edhe barërat anksiolitike dhe antidepresive.

Nga ekspertiza e vlersimit të dëmit në mjetin motorik, e punuar nga eksperti i komunikacionit të makinerisë Ing.dipl. B.L. e datës 23.10.2023, në bazë të fotove të automjetit të dëmtuar si pasojë e aksidentit, konstatoj se riparimi i dëmit të shkaktuar në automjet, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 16.09.2019, ka qenë teknikisht i mundur, dhe ekonomikisht i arsyeshëm. Lidhur me çmimoren e pjesëve të dëmtuara (krahun e parë të djathtë) që duhen të ndërrohen në automjetin e dëmtuar janë bazuar në vlerën mesatare të çmimeve të tregut vendor të autopjesëve për këtë lloj dhe tip të automjetit. Normativi i kohës së punës është marrë nga vlera mesatare për këtë lloje dhe tip të automjetit në Kosovë bazuar në vitin e prodhimit të tij. Riparimi i dëmit në automjetin "Peugeot 307", si shkaktar i aksidentit të komunikacionit të datës 16.09.2019, ka qenë teknikisht i mundur dhe ekonomikisht i arsyeshëm, vlera e riparimit të dëmit të automjetit (pa TVSH) sipas ekspertizës është 1,324.25 euro.

Me këto prova të administruara nga gjykata në emër të dhimbjeve fizike e aprovoj kërkesën e paditësve dhe atë për paditësin e parë S.M. në shumë prej 1,300.00 € ndërsa për paditësen e dytë M.M. në shumë prej 4,000.00 dhe e vlerësoj si shpërblim të drejtës dhe që i shërbejnë qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi, sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped/traumatolog, paditësi i parë si pasojë e lëndimeve të marra, ka pasur dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë që kanë zgjatur 1 ditë, kohë pas kohe gjer në marrjen e terapisë adekuate duke marrë parasysh lëndimet e gjoksit, barkut dhe brrylit, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 18 ditë gjer në marrjen e terapisë adekuate, dhimbje të intensitetit të ulët, ka edhe sot e kësaj dite posaçërishtë gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Ndërs paditësja e dytë si pasojë e lëndimeve të marra, ka pasur dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë që ka zgjatur 60 minuta, nga aksidenti deri në mjekimin dhe marrjen e terapisë kundër dhimbjeve, dhimbje fizike me intensitet të rëndë 4 ditë, dhimbje të manifestuara për shkak të lëndimeve të shumfishta trupore për shkak të thyerjes së kockës të cilat janë përcjellur me dhembje përkundër marrjes së terapisë kundër dhimbjeve. Me intensitet të mesëm 50 ditë, ndërsa me intensitet të ulët dhimbjet vazhdojnë sot e kësaj dite, sidomos gjat ngarkesës dhe ndryshimeve të motit.

Në emër të frikës së pësuar gjykata e ka caktuar shpërblimin për paditësin e parë S.M. shumën prej 1,100.00 € ndërsa për paditësen e dytë M.M. shumën prej 2,700.00 €, dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se, sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrit, Dr.sci. N.M.F. paditësi i parë ka përrjetuar frikë primare e cila ka zgjatur rreth dy sekonda në momentin kur e ka perceptuar mundësinë e goditjes së makinës dhe rrezikun fatal të vdekjes, ka përrjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë e manifestuar si shqetësim intensiv, duke u manifestuar me prishje të gjumit, dhimbje të qafës e kokës, plogështi dhe dridhje të trupit. Ka përrjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe atë për dy javë, e cila frikë është manifestuar me brengosje për gjendjen e tij shëndetësore dhe dhimbje të kohë pas kohshme në trup. Po ashtu në këtë periudhë ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, dhimbje trupi, ndjeshmëri të tepruar emocionale dhe nervozizëm, të shtuar sidomos të lidhur me vështirësitë në funksionimin e përditshëm. Është konstatuar edhe frikë sekondare e intensitetit të ulët që ka vazhduar reth një viti i manifestuar me frigë dhe pasiguri të kohë pas kohshme, prishje të gjumit, nervozizëm për të cilat ka marrë edhe trajtim psikiatrik. Ndërsa paditësja e dytë ka përrjetuar frikë primare e cila ka zgjatur rreth dy sekonda në momentin kur e ka perceptuar rrëshqitjen e makinës dhe rrezikun fatal të vdekjes, e cila është manifestuar në form të një britme çjerrëse. Ka përrjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të lartë 24 orë, e manifestuar si shqetësim intensiv, nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballej me gjendjen e sajë shëndetësore dhe mundësinë e përrjetimeve fatale për vetveten, ishte manifestuar me prishje të gjumit, mendimeve negative, shpërthim në vaj, dhimbje të trupit plogështi dhe dridhje të duarve. Po ashtu ka përrjetuar edhe frikë sekondare të intensitetit të mesëm dhe atë

një muaj e gjysmë, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme për gjendjen e sajë shëndetësore, nevojë e mjekimit me hospitalizim, ndërhyrje operative, ndihmë e personit tjetër si dhe dhimbje të kohë pas koshme në trup. Është konstatuar edhe frikë sekondare me intensitet të ulët, që ka vazhduar rreth një viti e përcjellur me frikë dhe pasiguri të kohë pas koshme, kujtime traumatike, pasiguri, nervozizëm, dhe vështirësi në përfshirje të aktiviteteve të lidhura me komunikacionin, e cila ka marrë edhe trajtim psikiatrik.

Në emër të dhimbjes për shkak të zvogëlimit të aktiviteti të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 20.80 %, për paditësen e dytë M.M. gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 10,000.00 € e ka vlerësuar si të drejtë duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped, atë për shkak të kontrakturës të nyjës së brrylit të djathtë si pasojë e lëndimeve të strukturave kockoro-ligamentoze me zvogëlim të lëvizshmërisë së nyjës së brrylit të djathtë në shkallë të mesme 10%, (dora dominante), për shkak të parezës të nervit radialis djathtas 12.5%, duke e krahasuar me dorën dhe gjendjen e shëndoshë ku edhe pas operimit, mjekimit dhe rehabilitimit konsiston në pamundësinë e paditëses që ti kryej aktivitetet e më parshme apo ti kryej me vështirësi e të cilat i ka kryer para lëndimeve pa vështirësi.

Në emër të shëmtimit trupor, paditësja M.M. ka në shkallë të mesme, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 2,000.00 €, e ka vlerësuar si të drejtë duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped, për shkak të vrugës si pasojë e plagës operative pas operimit në pjesën e përparme anësore të brrylit në nën e djathtë me gjatësi 20 cm, dhe gjerësi 1 cm, të dukshme kohë pas kohe, si dhe shëmtimit fizik, shtangimit të brrylit, dhe vështirësi në lëvizje, duke e marrur parasysh gjininë dhe moshën e re të paditëses.

Lidhur me shumën e kompensimit të dëmit jomaterial, gjykata vendosi në kuptim të nenit 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Në emër të ndihmës dhe kujdes të huaj gjykata për paditësin e parë S.M. ka caktuar shumën prej 252 € kurse për paditësen e dytë M.M. ka caktuar shumën prej 400 €, duke u bazuar në bazë të ekspertizës të ortopedit, ku kjo ndihmë ka qenë e nevojshme për paditësin e parë 18 ditë ndërsa për paditësen e dytë 50 ditë e cila ka konsistuar në ndihmë në kryerjen e nevojave të përditshme jetësore, ku për bazë gjykata ka marrë pagën prej 250 € si pagë mesatare në Republikën e Kosovës dhe pasi që paditësit kanë pasur nevojë për këtë ndihmë pasi që në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së “*Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*”.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata për paditësin e parë S.M. ka caktuar shumën prej 90 € kurse për paditësen e dytë M.M. ka caktuar shumën prej 250 €, duke u bazuar në bazë të ekspertizës të ortopedit, paditësi i parë ka pasur nevojë për 18 ditë kurse paditësja e dytë ka pasë nevojë për 50 ditë, për ushqim të përforcuar dhe atë të pasuruar me materie e nevojshme për arsyeje të rikuperimit të organizmit, gjykata konstaton se vlera prej 5 € për ditë do të kontribonte në pasurim të ushqimit të kërkuar si ushqim i përforcuar për paditësin e parë për 18 ditë gjykata ka vlerësuar si shumë prej 90.00 € dhe për paditësen e dytë për 50 ditë gjykata ka vlerësuar si shumë 250 €, si shumë adekuate për këtë ndihmë pasi që në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së “*Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*”.

Në emër të shpenzimeve të shërimit për ndërhyrje kirurgjike, kontrolla mjekësore dhe për blerjen e barnave, të bazuar në kuponat fiskal dhe në faturat, ku palët ndërgjyqëse nuk kanë kontestuese faturat dhe kuponat fiskale, në bazë të procesverbalit të datës 01.02.2024, ku shuma e tyre për paditësin e parë është 25.80 €, ndërsa për paditësen e dytë 1,391.50 €.

Në emër të dëmit material mbi vlerësimin e dëmit në mjetin motorik, gjykata ka caktuar shumën prej 1,324.25 €, bazuar në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Ing.dipl. B.L. riparimi i dëmit në automjetin “Peugeot 307” si shkak i aksidentit të komunikacionit të datës 16.09.2019, ka qenë teknikisht i mundur dhe ekonomikisht i arsyeshëm, vlera e riparimit të dëmit të automjetit pa TVSH është 1,324.25 €.

Gjykata i mori në tërsi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizave të lartpërmendur, ngase ekspertizat përmbajnë elementet e nevojshme të të dhënave mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1 i LMD-së janë parashikuar llojet apo format e shërbimit të dëmit jo material dhe atë për dhimbje e pësuar fizike për frikën e pësuar etj.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se e paditura mban përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësve me rastin e lëndimeve gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditësve t’ia kompensoj dëmin, konform nenit 159 dhe 136 të LMD-së.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore që i janë shkaktuar paditësve, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkuar si më lartë, gjykata e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke e vlerësuar si shpërblim realë dhe objektiv dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e dëmit.

Gjykata konsideron se shumata e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi paraqesin një satisfiksion moral dhe shpagim real për format e dëmit të pasuar të paditësve në aksidentin e komunikacionit, lëndimet dhe pasojat, duke marrë parasysh dhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 183 të LMD-së, standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës mbi shumata e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi ngase konsideroi se shumata e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila nevojitet që gjendja materiale të dëmtuarve të silltet aty ku do të ishte po mos të kishte ndodhur veprimi dëmtues. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shumata e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe nuk patën mbështetjeje në provat materiale – kuponat fiscal dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë deliktore civile të të paditurës.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me kërkesë për kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 382 paragrafi 2 të LMD-së pasi që palët paditëse kamatën e kanë kërkuar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 452 par. 3 dhe 463 të LPK-së dhe tarifës zyrtare për përfaqësime dhe atë për shpenzimet si në vijim: për përpilimin e padisë në shumën prej 312 euro, për përfaqësim në një seance gjyqësore në shumë prej 405.60 €, përfaqësimi në dy seanca gjyqësore në shumë të tërsishme prej 811.00 €, shpenzimet për pagesën e ekspertizave mjekësore 550 €, si dhe për ekspertizën e vlerësimit të dëmit në shumë prej 150 €, taksën gjyqësore në shumë prej 31 €, të gjitha në shumë prej 1.854.00 €.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr.246/2020, datë 01 Shkurt 2024

B.profesional
Ilir Sërtollaj

Gjykatësi
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në paraqitjen e ankesës, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.